



Qendrat e Drejtësisë në Familje për Qytetin e Nju Jorkut

(New York City Family Justice Centers)

Qendrat e të gjitha shërbimeve për ndihmën ndaj dhunës në familje

Çfarë janë Qendrat e Drejtësisë në Familje?

Qendrat e Drejtësisë në Familje për Qytetin e Nju Jorkut janë qendra për të gjitha viktimat e dhunës në familje dhe fëmijët e tyre si dhe viktimat e abuzimit ndaj të moshuarve. Për ta bërë sa më të lehtë marrjen e ndihmës, në çdo qendër ndodhen shumë agjensi. Shërbimet janë falas dhe i ofrohen të gjitha viktimave. Ne mund t'ju ndihmojmë pavarësisht nga gjuha që flisni.

Kur ju vizitoni një qendër, ju do të gjeni aty një ambient të sigurtë dhe të dashur me shërbime dhe mbështetje individuale. Në vizitën tuaj të parë në një qendër, ju do të takoheni me një specialist për klientin. Ata do të flasin me ju për shërbimet që ju keni nevojë. Specialisti më pas do t'ju lërë një takim me menaxherin e çështjes, i cili do t'ju shpjegojë dhe do t'ju ndihmojë me shërbimet që ofrohen nga qendra.

Qendrat ndodhen në ndërtesa të sigurta për të garantuar sigurinë tuaj. Çdokush që vjen në qendër duhet të kalojë përmes aparatit të sigurisë përpara se të hyjë në qendër. Ju lutem, sillni një dokument identiteti me fotografi me vete.

“Faleminderit shumë. Nuk e dija se sa shumë ndihmë kishte për mua. Ndiheh sikur tani kam një shans.”

- Klient FJC

Si mund të më ndihmojë Qendra e Drejtësisë në Familje?

Menaxhimi i çështjes Ju mund të takoheni me një menaxher të çështjes i cili vepron dhe kujdeset për nevojat tuaja, diskuton sesi të qëndroni e sigurtë dhe t'ju lidhë me shërbimet e ofruara.

Konsultimi Konsultimi ofrohet për ju dhe për fëmijët tuaj. Konsultime individuale dhe mbështetje në grupe janë në dispozicion.

Informacioni ligjor Avokatët dhe nëpunësit ligjorë janë në dispozicion për të biseduar me ju për çështje ligjore si për shembull kujdestarinë e fëmijëve, oraret e vizitave, dhe çështjet e emigracionit.

Policia Oficerët e Parandalimit të Dhunës në Familje nga departamenti i policisë së qytetit të Nju Jorkut që punojnë në qendër do t'ju ndihmojnë që të raportoni një krim. Ata mund t'ju japin edhe informacion sesi policia mund t'ju ndihmojë që të qëndroni të sigurtë.

Ndjekja penale Dhuna në familje është krim. Prokurorët nga zyra e Prokurorit të Zonës ndodhen në këto qendra. Prokurorët mund t'i përgjigjen çdo pyetjeje që ju keni në lidhje me sistemin e drejtësisë kriminale.

Dhoma e fëmijëve Fëmijët tuaj të moshës 3 vjeç e sipër mund të luajnë në Dhomën e Fëmijëve ndërkohë që ju merrni ndihmë.

Shërbimet në rast abuzimi ndaj të moshuarve Menaxherët e çështjeve, avokatët dhe prokurorët mund t'ju ndihmojnë nëse ju po përjetoni abuzim si pasojë e moshës.

Shërbimet e vetë-mbështetjes Personeli mund t'ju ndihmojë me asistencë nga shteti, buxhetin, kujdesin për fëmijën, dhe sigurinë financiare. Personeli mund t'ju lidhë gjithashtu me trajnime për vende pune ose programe arsimore.

Oraret, Vendndodhjet & Udhërrëfimet

Oraret: E hënë - E premte 9:00 paradite deri në 5:00 pasdite

Telefon: Telefono numrin 311 që të komunikoni me një qendër pranë jush.

Qendra e Drejtësisë në Familje për qytetin e Nju Jorkut, Bronx

Adresa: 198 East 161st Street, Bronx, NY 10451

Treni: 4, B ose D deri në stacionin e 161st Street Yankee Stadium

Autobus: BX1, BX2, BX6, dhe BX13

Qendra e Drejtësisë në Familje për qytetin e Nju Jorkut, Brooklyn

Adresa: 350 Jay Street, Brooklyn, NY 11201

Treni: A, C, F ose R deri në stacionin e Jay Street ose treni 2, 3, 4, ose 5 deri në stacionin e Borough Hall

Autobus: B25, B26, B38, B51, B54, B57, B61, B65, B67, dhe B75

Qendra e Drejtësisë në Familje për qytetin e Nju Jorkut, Manhattan

Adresa: 80 Centre Street, New York, NY 10013

Treni: 4, 5 ose 6 deri në stacionin e Brooklyn Bridge-City Hall, J ose Z deri në stacionin e Chambers Street, N ose R deri në stacionin e City Hall, 1, 2 ose 3 deri në stacionin e Chambers Street, ose A ose C deri në stacionin e Chambers Street

Autobus: M5, M9, M22 dhe M103

Qendra e Drejtësisë në Familje për qytetin e Nju Jorkut, Queens

Adresa: 126-02 82nd Avenue, Kew Gardens, NY 11415

Treni: E ose F deri në stacionin e Kew Gardens-Union Turnpike

Autobus: Q10, Q37, Q46, dhe Q60

Skuadra e Gatshme ndaj Dhunës në Familje në Staten Island

Për viktimat që jetojnë në Staten Island, telefononi 311 për të marrë informacion dhe referenca nga Skuadra e Gatshme e Shërbimit ndaj Dhunës në Familje në Staten Island. Për të mësuar më shumë, dërgoni email në adresën OCDV_DVRT@cityhall.nyc.gov ose vizitoni www.nyc.gov/domesticviolence.



Mayor's Office to
Combat Domestic Violence

Si të qëndroni të sigurtë

Nëse po ju abuzojnë, këto janë hapat që mund t'ju ndihmojnë që të qëndroni të sigurtë:

- Telefoni 911 nëse jeni në rrezik ose jeni lënduar nga partneri juaj.
 - Mësoni fëmijët tuaj sesi të përdorin telefonin për të thirrur policinë dhe të fshihen në një vend të sigurtë gjatë një incidenti të dhunshëm.
 - Gjeni një vend të sigurtë për veten dhe fëmijët tuaj që të shkoni në raste urgjente.
 - Mbyllni të gjitha dritaret dhe dyert gjatë natës dhe kur dilni nga shtëpia.
 - Informoni shkollën, kopshtin e fëmijëve tuaj se kush ka leje për t'i marrë fëmijët.
 - Kërkoni që numri juaj të mos jetë i regjistruar në numratorin telefonik.
 - Mbajeni konfidenciale adresën e shtëpisë, dhe nëse është e mundur, mos i tregoni abuzuesit tuaj se ku jetoni.
 - Shmangni daljet vetëm.
 - Nëse është e mundur, i kërkoni dikujt të marrë shënim telefonatat në punë, kërkoni që numri i telefonit të zyrës dhe adresa elektronike e emailit të ndryshojnë, ndryshoni rrugën që bëni kur shkoni dhe ktheheni nga puna, dhe ndryshoni orarin e punës.
- Në rast se ju duhet të largoheni me të shpejtë, merrni dokumente të rëndësishme për veten dhe fëmijët:
 - Pasaporta/Kartat Jeshile (Grin Kartat)/ Lejet e punës
 - Kartat e Numrit të Punës /Çertifikatat e Lindjes
 - Letrat e Bankës/kartat e kreditit/blloqet e çeqeve
 - Taksat/çeqet e punës
 - Tapinë e shtëpisë/Kontratën e qirasë
 - Urdhrin e Mbrojtjes
 - Urdhrin mbi Kujdestarinë/ Orarin e vizitave
 - Çertifikatën e Martesës
 - Kartën e vaksinave/ dokumentet e shkollës së fëmijëve
 - Librin e adresave dhe telefonin celular me parapagesë
 - Fotografinë e abuzuesit
 - Prova të abuzimit duke përfshirë emaile, mesazhe në telefon ose shkrime në ditar
 - Paketoni një çantë me para, çelësa, veshmbathje, ilaçe, dhe këto dokumente të rëndësishme dhe ruajini në një vend të sigurtë ose lërinë tek dikush që ju keni besim.

“Ky program më ka ndihmuar të tejkaloj një nga periudhat më të vështira të jetës time. Gjithmonë më ka ofruar një hapësirë të sigurtë për të mbledhur mendimet e mia, për të përdorur telefonin, dhe të kërkoj për punë në kompjuterat e tyre. Sa here që kisha nevojë, ky program më ka pritur gjithmonë krahëhapur.” – Klient FJC

Nëse ju ose dikush që ju njihni është viktimë e dhunës në familje, ne të ofrojmë ndihmë.
Telefoni numrin 311 për Linjën 24 orëshe të Ndhmës ndaj Dhunës në Familje për Qytetin e Nju Jorkut.
Telefoni numrin 911 në raste urgjente
Ndhma ofrohet në të gjitha gjuhët

www.nyc.gov

Partnerët

The Arab American Family Support Center, Inc./Tamkeen
Barrier Free Living
Bronx County District Attorney's Office
CAMBA
Center Against Domestic Violence
Day One
FEGS
The Financial Clinic
Garden of Hope
Good Shepherd Services Safe Homes Project
Her Justice
Jewish Association Serving the Aging
Jewish Board of Family and Children's Services
Kings County District Attorney's Office

Korean American Family Service Center
Legal Services NYC - Bronx
Manhattan Legal Services NYC
Metropolitan Council on Jewish Poverty
Mount Sinai Sexual Assault & Violence Intervention Program
New York Asian Women's Center
New York City Anti-Violence Project
New York City Department of Information Technology and Telecommunications
New York City Human Resources Administration
New York City Police Department
New York County District Attorney's Office
New York Legal Assistance Group
Northern Manhattan Improvement Corporation

Queens County District Attorney's Office
Queens Legal Services
Safe Horizon
Sanctuary for Families
Sauti Yetu Center for African Women
Shorefront Y
South Brooklyn Legal Services
STEPS to End Family Violence
St. Luke's Roosevelt Crime Victims Treatment Center
Urban Justice Center
Urban Resource Institute
Violence Intervention Program, Inc.
Weinberg Center for Elder Abuse Prevention
WISE (Working in Support of Education)